



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. \_\_\_\_\_/2019

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9831,DATE 12.11.2007,**  
**”PËR DËMSHPËRBLIMIN E ISH TË DËNUARVE POLITIKË**  
**TË REGJIMIT KOMUNIST”,TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78,81,pika 1,dhe 82,të Kushtetutës,me propozimin e deputetit Artur Roshi , Kuvendi i Shqipërisë

**VENDOSI :**

Në ligjin nr.9831,datë 12.11.2007,”Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”,të ndryshuar,bëhen këto ndryshime :

**Neni 1**

Në nenin 1, në paragrafin e dytë mbas shprehejes, “Objekt i këtij ligji është edhe dëmshpërblimi i familjarëve të viktimave”,të shtohet “të egzekutuar pa gjyq” dhe shprehja në vazhdim të kësaj fjalie , “gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991” të ndryshohet “gjatë periudhës 08.11.1941 deri më 1.10.1991”.

**Neni 2**

Në nenin 6 , në pikën “ c “ të tij, fjalia e fundit , ” Nga shuma që çdo i dënuar politik përfiton nga ky ligj ,zbritet masa e dëmshpërblimit që ai ka përfituar me ligjet e mëparshme ”, te ndryshohet , “ Nga shuma që çdo i dënuar politik

përfiton nga ky ligj ,të mos zbritet masa e dëmshpërblimit që ai ka përfituar me ligjet e mëparshme ”.

### **Neni 3**

Në nenin 7, pjesa e fundit e fjalisë së parë , “ në masën e 8 viteve kompesim dënimi me burgim “ , të ndryshohet “ në masën e 25 viteve kompesim dënimi me burgim “.

### **Neni /o**

Hyrja ne fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**Gramoz RUÇI**